

PROCESET GJUHËSORE, IDENTITETI KULTUROR DHE GLOBALIZIMI (LINGUISTIC PROCESSES, CULTURAL IDENTITY, AND GLOBALIZATION)

Mustafa IBRAHIMI

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Universiteti i Evropës Juglindore,
Tetovë, MAQEDONI

E-mail: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

PËRMBLEDHJE

Proceset e globalizimit dhe bashkimi i Evropës sollën ndryshime të shumta, në mesin e tyre edhe ndryshimet që kanë të bëjnë me vetëdijen gjuhësore dhe kulturore të folësve, që pa mëdyshje ndikon edhe në strukturën gjuhësore. Këto ndryshime janë të dyanshme dhe fort të lidhura njëra me tjetrën. Nga njëra anë gjuhët ndjehen të rrezikuara nga gjuhët dominuese, nga ana tjetër atmosfera ekzistuese se globalizmi ndikon vetëm negativisht, sikur na pengon t'i vërejmë përpjekjet dhe anët pozitive që sjell ai. Fakt është se këto procese integruese kanë sjellë deri te ndryshimet natyrore gjuhësore, por kanë krijuar edhe nevojën për përcaktimin e serishëm të identitetit gjuhësor, kulturor dhe etnik.

Fjalët kyçe: *gjuha, kultura, identiteti, globalizimi*

ABSTRACT

Globalization processes and those regarding the entry into the EU brought many changes, such as, the changes that are related to the linguistic and cultural awareness of native speakers, which, certainly affects also the language's structure. These are mutual changes and are closely correlated. On one hand, languages are currently being exposed to danger from present dominant languages, yet, on the other hand, the existing impression that

globalism has, however, only negative impact, has made us unable to notice the efforts and positive implications that globalism brings to us. It is for a fact that these integration processes have contributed to natural change of languages, but have also brought the urge for another attempt to determine the linguistic, cultural, and ethnic identity.

HYRJE

Gjatë shekujve ka pasur përpjekje të shumta që pluralizmi global i gjuhëve të zëvendësohet vetëm me një gjuhë. Gjithçka filloi në shek. XVII, kur në Evropë lindi ideja për zgjidhjen e problemeve që paraqiten nga shumëgjuhësia dhe mund të zgjidheshin *in vitro* duke bërë të mundur krijimin e një gjuhë universale, një gjuhë e përbashkët ndërkombëtare si mjet komunikimi, p.sh. esperanto. Në shek. XX dhe në fillim të shek. XXI anglishtja krijoi pozicion hegjemonist ndaj gjuhëve tjera, kurse sipas ekspertëve në përgjithësi në vitin 2050 asnjë gjuhë nuk do ta më këtë pozicionin (Graddol 1997:58).

Atëherë lind pyetja: Pse gjuhët janë të kërcënuara të shuhen dhe çfarë do të ndodhë me to në të ardhmen? Një nga shkaqet është globalizimi që ka shekuj që thellohet. Në një botë që bëhet gjithnjë e më shumë e ndërvarur, gjuhët më të vogla rrezikojnë të shtyhen derisa madje edhe të

shuhen nga dukja. Kërcënime të tjera për gjuhën janë edhe vrasjet e racave shoqërore dhe sëmundjet ngjitëse shfarosëse.

Pra, nuk ishte ideja e tyre për një shoqëri një-gjuhëshe, si para ngjarjes dramatike në Babiloni, as ideja për një shoqëri njëgjuhëshe me një gjuhë të përbashkët ndërkombëtare si mjet komunikimi, p.sh. si esperanto, por për shtet njëgjuhësh kombëtar. Këto të drejta rreth trashëgimisë në fakt janë lojëra politike-gjuhësore, duke i lënë hapësirë lindjes së nacionalizmit (Kalve 1981:22).

Përkundër rrezikut të gjuhëve nga globalizimi, gjuhët shtohen dhe marrin një rëndësi më të madhe identiteti. Këtë më së miri e pasqyron A. Meje, i cili thekson se “paradoks në vete është thënia: *Bota mundohet të ketë vetëm një civilizim, por gjuhët e civilizimit shumëzohen në të*”.

MITET DHE KONCEPTET E NDRYSHME ROMANTIKE MBI GJUHËT

Për t'i kuptuar më mirë proceset globale që lidhen me gjuhën dhe identitetin e një populli, më së miri na e shpjegon miti për Kullën e Babilonit që ende është i gjallë edhe sot e kësaj dite dhe ngërthen në vete shumë porosi por edhe misterin për vetekzistencën e një shteti shumëgjuhësor dhe shumënacional. Kjo kullë, që e kanë përmendur shumë studiues, ka mbetur e pranishme në kujtimet e popullit, në ndërgjegjen e tyre kolektive si një simbol mjaft i ndërlikuar. Në këtë tregim të vjetër për lindjen e pluralizmit gjuhësor dhe dallueshmërisë së gjuhëve komentohet si mospajtim midis planeve dhe kryeneçsisë së njerëzve (dëshira për të hipur në qiell) dhe dënimi i zotit për atë kryeneçësi. Andaj dënimin e vetëm që kanë mundur ta marrin nga zoti ka qenë ekzistimi i shumë gjuhëve në një shoqëri, si dënim por edhe mallkim që mos të kuptohen njëri me tjetrin çka flasin. Në këtë mënyrë zoti i shkapërderdhë nëpër tokë e ata nuk arritën ta mbarojnë ndërtesën. (Ibrahimi 2003:28).

Ajo që më së shumti na intereson nga ky tregim, është se zoti e ka dënuar njerëzimin me ekzistencën e shumë gjuhëve dhe i shpartalloi ata, edhe pse në fillim zoti kishte krijuar vetëm një gjuhë dhe fjalë të njëjta në tërë botën. Ky mit, sigurisht ka frymëzuar ithtarët e idesë për shoqëritë

monolinguale, që janë mbështetur edhe në burime të tjera. Përpyekjet që pluralizmi global i gjuhëve të zëvendësohet me një gjuhë e dëshmojnë shkrimet e Jan Kominskit në veprën *Dyert e hapura të gjuhëve* (1631), por edhe letra e Rene Dekartit i cili nga Amsterdami zhvillonte një këmbim shkencor më 20 nëntor 1629, ku thekson se “një gjuhë e tillë është e mundshme sikur të gjithë njerëzit të mësojnë latinishten (Kalve 1995:311-312). Gjatë kësaj periudhe e më vonë, studiuesi Pjer Zhantoni do të vlerësojë se ekzistonin gjithsej 500 përpjekje për krijimin e gjuhëve artificiale (Janton 1973:13). Nga viti 1858 deri më 1914 mund të numërojmë me qindra gjuhë të tilla artificiale. Por nga kjo listë e gjatë, vetëm gjuhët *volapük* dhe *esperanto* arritën të kenë sadopak sukses.

Edhe pse qëllimi me këto gjuhë ndërkombëtare ishte krijimi i shoqërive monolinguale në Evropë. Në shek. XVIII-XIX ende vazhdonte periudha e romantizmit, që ishte periudha e ndryshimeve të mëdha shoqërore, lëvizjeve nacionale ku rëndësi i jepej gjuhëve dhe folklorit. Kjo është periudha e zhvillimit të ndërgjegjes kombëtare dhe realizimit të ideve për shtete nacionale, ku ishin qartësuar qëndrimet për një gjuhë të përbashkët, jo për një gjuhë universale botërore por për një gjuhë nacionale botërore. Për këtë dëshmojnë konceptimet romantike të disa popujve evropianë që kishin filluar shumë herët. P.sh. i huaji, i cili nuk fliste greqisht, për qytetarët e Athinës do të cilësohej si “barbar”, gjermanët gjuhën e tyre e kanë konsideruar si “gjuhë me fuqi mbinatyrore”, francezët kryesisht mbështeteshin në atë se “gjuha e tyre është aq e qartë dhe e logjiksme saqë çdo mendim në gjuhën frënge del logjikisht”, kurse anglezët pohonin se “zoti mund të flasë vetëm me gjuhën e tyre” (Bugarski 1975:200). Të gjitha këto pohime ideologjike dhe politike që i plasuan këto shtete gjatë shekullit XVI e këndej, kishin për bazë zhvleftësimin sistematik të gjuhës së tjetrit. Prej këtu lindi edhe racizmi, nacionalizmi dhe kolonializmi, ku si bartës kryesor ishin pikërisht këta shtete.

SITUATA GJUHËSORE DHE NDRYSHIMET GJEOPOLITIKE

Pas kësaj periudhe, evropianët krijuan kulturën e parë të vërtetë botërore (Spybey, cit. në Milar-

dović,1999.). Duke krijuar kolonitë mbretërore të disa shteteve evropiane jashtë kufijve të Evropës, shumë popuj erdhën nën ndikimin e kulturës evropiane (Milardović, 1998). Gjatë kolonializmit shtetet evropiane në botën e re bartën edhe institucionet shtetërore, fetare dhe politike. Kolonitë e tyre ishin thjesht anekse të shteteve amë, kurse shtetet evropiane i kishin nën kontrollin politik dhe fetar shumë prej shteteve të tilla. Madje edhe qytetet dhe lagjet e emigrantëve evropianë ishin pothuaj identike me shtete prej nga vinin. Gjuhët filluan të barten nga njëra anë e botës në tjetrën. Kështu me zgjerimin e perandorisë romake latinishtja u shndërrua në *lingua franca* në Mesdhe dhe në pjesën më të madhe të Evropës; zgjerimi i islamizmit solli deri te dominimi i gjuhës arabe në Lindjen e afërt dhe në Afrikën Veriore. Ekspansioni i rusëve në lindje dhe kinezëve në perëndim rezultoi me përhapjen e gjuhëve të tyre në vendet e pushtuara. E njëjta gjë ndodhi edhe me gjuhët evropiane (spanjishtja, portugalishtja, anglishtja dhe frëngjishtja) të cilat pas zbulimeve dhe kolonializimit të kontinentit amerikan, Afrikës dhe Australisë dhanë të njëjtin kontribut. P.sh. në Amerikën Latine edhe sot e kësaj dite flitet spanjisht, gjegjësisht portugalisht, pasi edhe kjo ishte gjuhë e kolonizatorëve.

Në të njëjtën kohë me eksportimin e gjuhëve të kolonizatorëve filloi edhe procesi i tkurrjes dhe i zhdukjes së gjuhëve autoktone të vendasve. P.sh. kur në shek. XVI portugalishtja arriti në Brazil, për një kohë shumë të shkurtër u zhdukën 75% të gjuhëve burimore autoktone, kurse prej 208 gjuhëve që dihet se janë folur në Brazil, në fund të shek. XX ka mbetur vetëm një gjuhë me 10.000 banorë nga gjithsej 160 milionë banorë në Brazil; deri sot kanë ngelur vetëm 20 nga 250 gjuhët vendase të aborigjenëve në Australi të cilat fliteshin gjatë ardhjes së evropianëve në Australi më 1788; në Alaskë ka vetëm 2 gjuhë nga 20 të mëparshmet etj. (*Speaking...* 1997:53; usj. Watson 1999:8-9).

Kjo praktikë e zgjerimit të disave dhe zhdukja e të tjerëve vazhdon edhe sot nën trysinë e të ashtuquajturit globalizimi joliberal që krijon modelin e "multikulturalizmit të korporatave" që sjell në pyetje pluralizmin e kulturave, me çka zhdukja e gjuhëve rrjedh shumë shpejt. Mesatarisht çdo dy

javë një gjuhë i humb folësit e vet pasi vdesin ose nuk flasin më. Pra nëse për dy javë vdes një gjuhë, kjo do të thotë se për një vit janë 25 të tilla. Pra, nëse nuk hartohet një politikë globale për gjuhët e rrezikuara, në shekullin XXI do të zhduken krejtësisht rreth 80% e gjuhëve në botë, 10% do të mbahen vetëm në formën gojore midis folësve të popullatës së mesme dhe të vjetër (d.m.th. nuk do të mësohen në shkollë) dhe vetëm 10% ose 600 gjuhë do të kenë folës që do t'i përcjellin brezave të ardhshëm dhe ashtu do të vazhdojnë të përdoren (*Cambridge Encyclopedia of Language* 1996; Crystal 1997; usj. Watson 1999:9). Por ka edhe parashikime pesimiste se deri në mesin e shek. XXI do të zhduken deri 90% e numrit të përgjithshëm të gjuhëve të sotme të gjalla (Grbić 2004:244).

Janë të pranueshme konstatimet e gjuhëtarëve, ekonomistëve, sociologëve, politikanëve etj. se në shumicën e vendeve të pazhvilluara dhe në zhvillim, ato janë në tranzicion multilingual ose multikulturor se kanë një numër të madh analfabetësh në ato shtete. Për dallim nga ta, shtetet njëgjuhësore homogjene janë më të zhvilluara ekonomikisht, kanë arsim të përparuar, politikë moderne dhe nga aspekti ideologjiko-politik janë më të qendrueshme (Fishman 1968, Watson 1999:6). Këtë mund ta ilustrojmë me shembuj konkretë: sot në botë fliten rreth 6000 gjuhë, prej tyre në Evropë 3%, në Afrikë 30%, në të dyja Amerikat 15%, në Azi 32%, kurse në Pacifik 19%. Nga kjo mund të shihet se në shtetet e zhvilluara përdoren vetëm disa gjuhë, kurse në të tjerët më tepër (Maurais 2004; Skutnabb-Kangas 2001; Maffi 2002; Fishman 2000; *The World's...* 2001; *Winners...* 2000; Watson 1999; Crystal 1997; Bugarski 1997a; Raloff 1995).

Sipas hulumtimeve të zhvilluara në British Council, të koordinuara nga David Graddol, ekzistojnë tregues se dominimi global i anglishtes mund të dobësohet. Ai vjen në përfundimin se gjuha angleze përafërsisht në mesin e shek. XXI nuk do ta ketë më monopolin gjuhësor por do të jetë pjesë e "monopolit të disave", gjegjësisht secili do të ketë pushtet në domenin e vet (Graddol 1997).

PËRFUNDIM

Problemi i globalizimit si proces botëror mund të shihet edhe si proces pozitiv, për shkak se mund

të ndihmojë në zhvillimin e shteteve të pazhvilluara. Kjo hap pyetjen e zhvillimit dhe rëndësinë e gjuhëve nacionale, sidomos të popujve të vegjël evropianë.

Pyetjes se pse gjuhët do të ekzistojnë, mund t'i përgjigjemi se ato janë pjesë e identitetit etnonacional e identitet janë ngulitur thellë në vetëdijen e folësve. Shtetet evropiane shumë herët e formonin identitetin e tyre në bazë të vlerave kulturore të rrënjësura thellë në gjuhë. Shtetet e reja të lindur nga nacionalizmi e rritën edhe më shumë numrin e gjuhëve zyrtare në Evropë. Qoftë ta arsyetojmë, qoftë edhe ta dënojmë këtë, bëhet fjalë për një nga karakteristikat më të theksuara të kontinentit të vjetër, që i jep botës edhe vlera kulturore. Këtë e mundëson edhe *Karta e të drejtave të njeriut* që është kusht për çdo praninë të ri në familjen evropiane, nëse i respekton gjuhët e nacionaliteteteve.

Për ta përmbyllur, dëshiroj të vë në dukje se çështja është për një orientim tërësor kulturor, duke u mbështetur në thënien "të punosh në ekonominë globale – të jetosh në kulturën lokale" (Castellas, 1997). Ndoshta në të ardhmen në Evropë do të ishte i mundur krijuar një arsimim i gjuhëve, ku si efekt parësor do të ishte rritja e numrit të poliglotëve të vërtetë.

BIBLIOGRAFIA

- BUGARSKI, R. (1997a). *Jezici*. Beograd: Čigoja štampa. (XX vek].
- CASTELLAS, M. (1997) *European Cities, the informational society and global economy*, in: An Gray and Jim McGuigan, "Studying Culture (An Introductory Reader)", Arnold.
- CEL (1996). *Cambridge Encyclopedia of Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- CORSON, D. (1990). *Language Policy across the Curriculum*, Clevedon.
- CRYSTAL, D. (1997). *English as a Global Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Defenders... (2000). "Defenders of Diversity". *UNESCO Courier* 53/4:30-32.
- FISHMAN, A.J. (1968). *Reading in the Sociology of Language*. The Hague: Mouton De Gruyter.

- FISHMAN, A.J. (2000). "English: 'The Killer Language? Or a Passing Phase?'"'. *Whole Earth*, Spring.
- FISHMAN, A.J. (2000). "English: 'The Killer Language? Or a Passing Phase?'"'. *Whole Earth*, Spring.
- FISHMAN, A.J. (1978), *Sociologija jezika. Interdisciplinarni društvenonaučni pristup jeziku u društvu*. Sarajevo: Svjetlost.
- GAJIĆ, R. (1980). *Živi jezik*. Niš: Gradina.
- GRADDOL, D. (1997). *The Future of English*. London: The British Council.
- GRBIĆ, J. (2004). *Jezični procesi, identitet i globalizacija*. Nê Narodna umjetnost, 41/2. Zagreb.
- HARLOW, J.D. (2003). *How to Build a Language*. <http://www.donh.best.vwh.net>.
- IBRAHIMI, M. (2003). *Interpretime dhe studime gjuhësore*. Interlingua, Shkup.
- JANTON, P. (1973). *L'esperanto*. Paris.
- KALVE, L. (1981). *Lingvistika i kolonijalizam*. Beograd.
- KALVE, L. (1995). *Rat mežu jezicima*. Beograd.
- MAFFI, L. 2002. "Endangered languages, endangered knowledge". *International Social Science Journal* 54/173:385-393.
- MAURIS, J. (2004). "Towards a new linguistic world order". U *Languages in a Globalising World*. J. Maurais i M. A. Morris, ur. Cambridge: Cambridge University Press, 13-36.
- MILARDOVIĆ, A. (1998) *Poraz Europe*, Pan Liber, Osijek-Zagreb-Split, pp. 271.
- MILARDOVIĆ, A. (1999) *Globalizacija*, Pan Liber, Osijek-Zagreb-Split.
- MÜHLHÄUSLER, P. (1994). "Babel revisited". *UNESCO Courier* 47/2:16-21.
- RALOFF, J. (1995). "Languishing languages: Cultures at risk". *Science News* 147/8:117-118.
- SHKURTAJ, G. & MEMUSHAJ, R. (1998). *Shkolla dhe shqipja letrare*. "Gjuha jonë", nr. 1-4/1998, Tiranë, f. 56-63.
- SKUTNAB, B. & KANGAS, T. (2001). "The Globalisation of (Educational) Language rights". *International Review of Education* 47/3-4:201-219.
- Speaking... (1997). "Speaking in Tongues". *Time Magazine*. July 7:52-58.
- The world's... (2001). "The World's linguistic Diversity". *World Watch* 14/3:38-39.
- WATSON, K. (1999). "Language, power, development and geopolitical Changes: conflicting pressures facing plurilingual societies". *Compare* 29/1:5-22.
- Winners... (2000). "Winners and Losers". *UNESCO Courier* 53:4.